VENDIM
Nr. 401, datë 30.6.2021

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË HOLLËSISHME PËR MIRATIMIN DHE KOMPETENCAT E TRUPAVE CERTIFIKUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret e hollësishme për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikuese, që do të kryejnë procesin e verifikimit të përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara, si: EOM, TGJM dhe STG me specifikimet përkatëse.

2. Përveç përkufizimeve të parashikuara në ligjin nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore", termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Komision", komisioni për miratimin dhe auditimin e trupave certifikuese (KMATC);

b) "Ligj" i referohet ligjit nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore";

c) "Trupë certifikuese", ka kuptimin referuar nenit 23, të ligjit nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore".

II. KRITERE TË PËRGJITHSHME

1. Trupa certifikuese e akreditуar që paraqet kërkesën për miratim, referuar pikës 2, të nenit 23, të ligjit, siguron dëshmi dhe informacion lidhur me:

a) certifikatën e akreditimit, që konfirmon përputhshmërinë me kërkesat e ISO/IEC 17065, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si EOM, TGJM dhe STG;

b) statusin ligjor, qëllimin e aktivitetit dhe organigramën;

c) procedurat e detajuara për verifikimin e sistemit të përputhshmërisë për produktet bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM;

ç) paanshmërinë dhe lirinë nga çdo konflikt interesi lidhur me ushtrimin e detyrave që i janë ngarkuar;

d) fushën e akreditimit dhe fushën për të cilën kërkon miratim;

dh) adresën dhe kontakte të sakta.

2. Trupa certifikuese duhet të provojë që inspektorët nuk kryejnë më shumë se 3 (tri) inspektime rresht tek i njëjti prodhues.

III. KRITERE PËR BURIMET NJERËZORE

1. Kualifikimet minimale të inspektorëve të trupave certifikuese janë, si më poshtë vijon:

a) arsim i mesëm i lartë, ose i lartë në bujqësi, ose arsim i lartë në teknologji ushqimore;

b) të paktën 2 (dy) vjet, në 5 (pesë) vitet e fundit, eksperiencë profesionale në fushën e kontrollit të prodhimit bujqësor ose ushqimor përkatës;

c) trajnime për kryerjen e inspektimeve të kontrollit në fushën e bujqësisë ose të procesit të prodhimit ushqimor përkatës;

ç) kurse dhe trajnime lidhur me produktet tradicionale bujqësore ose ushqimore.

2. Një trupë certifikuese mund të vendosë kërkesat e veta kualifikuese për stafin e saj, duke siguruar që ato të mos jenë më të ulëta se kriteret minimale të vendosura në pikën 1, të këtij kreu dhe që plotësojnë kërkesat e ISO/IEC 17065.

3. Kërkesat sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, duhet të jenë të dokumentuara.

IV. PËRMBAJTJA/TË DHËNAT E CERTIFIKATËS SË CILËSISË

1. Certifikata e cilësisë e lëshuar nga trupa certifikuese përmban informacion shtesë lidhur me:

a) numrin e identifikimit dhënë trupës certifikuese gjatë procesit të miratimit nga KMATC-ja;

b) numrin e certifikatës dhënë operatorit ushqimor.

V. KOMPETENCAT E TRUPAVE CERTIFIKUESE

1. Trupa certifikuese kryen verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara, si: STG, EOM dhe TGJM, me specifikimet përkatëse të produkteve para vendosjes së tyre në treg, referuar pikës 1, të neneve 22 e 23, të ligjit.

2. Trupa certifikuese lëshon certifikatën e cilësisë, që konfirmon përputhshmërinë e produkteve bujqësore apo ushqimore me specifikimet, referuar pikës 4, të nenit 26, të ligjit.

3. Trupa certifikuese, gjatë çdo inspektimi, merr informacion nga prodhuesi lidhur me vëllimin e vlerësuar të prodhimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe